

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/departamenti i përgjithshëm-Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Kujtim Krasniqi, me zyrtaren Ligjore Dafina Ymeri, në çështjen penale të të pandehurit M. B. nga P., për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.2 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2018/14, të datës:21.12.2015 në bazë të nenit 358, par. 1, nën par. 1.3, të KPPK dhe nenit 12, par.12.5, të Ligjit mbi ndërmjetësimin, me datë 30.01.2018, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim, e lidhur në mes të pandehurit **M. B.** dhe i dëmtuari **A. B.** nga P. në E. rr. "...", në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prishtinë QN. 5/2018, e datës 22.01.2018.
- II. **HUDHET** Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr. 2018/14, të datës:21.12.2015.
- III. **PUSHOHET** procedura penale për të pandehurin **M. B.,,** nga i ati F., i lindur me *data e lindjes...*, nga P. me vendbanim në rr. "...", nr... , shqiptar – shtetas i Republikës së Kosovës.

-për shkak të veprës penale Vjedhje nga neni 325 par.2 të KPRK-së
- IV. **Obligohet;** në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **30** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm, me aktakuzën PP.II.nr. 2018/14, të datës:21.12.2015, ka akuzuar **M. B.** nga P., për veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së

Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësorë me dt: 17.01.2018 në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit Rrahim Podvorica, i pandehuri, dhe i dëmtuari A. B..

Me propozimin dhe pajtimin e palëve, të akuzuarit dhe të dëmtuarit A. B. të cilët i kanë propozuar gjykatës që këtë çështje ta dërgojnë në procedurën e ndërmjetësimit dhe pas dhënies së mendimit dhe pajtimit nga prokurori i shtetit që këtë çështje penale juridike ta dërgoj për marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit , gjykata me aktvendim pranoi propozimin e palëve dhe këtë çështje penale juridike konform ligjit për ndërmjetësim dhe KPPRK-së

Me datë 22.01.2018, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prishtinë, është lidhur marrëveshja QN. 5/18 për zgjidhjen e ndërmjetësuar ndërmjet të pandehurit M. B. dhe të dëmtuarit A. B..

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetimi dhe konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit vendosi që ta aprovoj marrëveshjen si të bazuar.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 454 par.3 të KPPK-së.

Andaj, duke u bazuar në provat si më lart dhe në bazë të nenit 358, par. 1, nën par. 1.3, të KPPK dhe nenit 12, par.12.5, të Ligjit mbi ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i përgjithshëm-Penal
P.nr.4192/15, datë 30.01.2018

Zyrtare Ligjore,
Dafina Ymeri

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Kujtim Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë.